

VENDIM
Nr. 98, datë 4.7.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË DHE MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË PROPOZUAR NGA OST SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, neni 21 i Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/EC, neni 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 3092 Prot., datë 5.6.2017, paraqiti pranë ERE-s kërkesën për miratimin e vendimit të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë OST sh.a., me anë të të cilit ka emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, si dhe ka miratuar kontratën e ofrimit të shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë midis OST sh.a. dhe zyrtarit të pajtueshmërisë.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 43, datë 15.3.2017, ka vendosur “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

- Kërkesa e shoqërisë OST sh.a., për miratimin e kontratës së ofrimit të shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, daton 5.6.2017 dhe është në zbatim të kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.” dhe në përmbushje të detyrave të caktuara nga Direktiva 2009/72/EC.

- ERE ka kompetencën për të miratuar kontratën e zyrtarit të pajtueshmërisë.

- Shoqëria OST sh.a., nëpërmjet organeve të saj drejtuese, ka të drejtën të propozojë për miratim në ERE zyrtarin e pajtueshmërisë së zgjedhur nga këto organe.

- Kontrata e zyrtarit të pajtueshmërisë në shtojcën 2 të saj ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrtari i pajtueshmërisë.

- Shoqëria OST sh.a., në shkresën e saj nr. 3092 Prot., datë 5.6.2017, nuk ka bërë me dije në lidhje me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 2 të draftkontratës nga zyrtari i përzgjedhur dhe emëruar nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga shoqëria OST sh.a.

2. Shoqëria OST sh.a. të dokumentojë plotësimin e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 2 të draftkontratës nga zyrtari i propozuar për miratim.

3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga

botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti